



INAUGUROHET IMPIANTI I PASTRIMIT TË GRYKËDERDHJES SË LUMIT SHKUMBIN



Mbi 40 hektarë plazh në grykëderdhjen e lumit Shkumbin, të cilat nuk shfrytëzoheshin prej ndotjes së lartë, janë në kushte optimale dhe mund të shfrytëzohen nga pushuesit vendas dhe të huaj përgjatë sezonit turistik veror 2017.

Falë një investimi të Ministrisë së Mjedisit, në grykëderdhjen e lumit Shkumbin, është bërë e mundur që një hapësirë e madhe plazhi tashmë të jetë funksionale.

Një impiant i montuar në grykëderdhje të lumit, i cili kryen funksionin e pastrimit të lumit nga mbetje të ndryshme, do të mbajë të pastër këtë vijë bregdetare, që prej vitesh ishte futur në listën e plazheve më të ndotura të Shqipërisë.

Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, tha se përfundimi i këtij investimi i ka shtuar hartës së Shqipërisë 40 hektarë plazh funksional dhe do të mbajë të pastër të gjithë vijën bregdetare të grykëderdhjes së lumit Shkumbin. Ministri Koka shtoi se: "Ky është një investim që disiplinon

qoftë mbetje e ngurta, ato plastike dhe vajrat. Gjithashtu edhe investimi që ka filluar në grykëderdhjen e Ishmit, do të çojë në dy numrin e grykëderdhjeve të lumenjve që rehabilitojmë. Kemi një problematikë shumë të madhe kryesisht me hidrokarburet. Industria e naftës në zonën e Fierit dhe Ballshit, ka sjellë një ndotje të tejkajshme në lumin e Gjanicës. Fatkeqësisht nuk kemi mundur deri sot që të zgjidhim këtë problematikë në mënyrë definitive, por besoj shumë shpejt, një nga aksionet e Ministrisë së Mjedisit, para fillimit të sezonit turistik, do të jetë edhe ndërhyrja në këto aktivitete, për të mundësuar një vijë bregdetare sa më të pastër, të shëndetshme për qytetarët shqiptarë dhe ata të huaj"- deklaroi ministri i Mjedisit.

Ky impiant pastrimi do të ketë një mision mjaft të rëndësishëm, për sa i përket mbajtjes pastër të vijës bregdetare. Investimi në fjalë ka një vlerë prej një milion dollarësh, ndërkohë vijon puna për pastrimin e grykëderdhjes së lumit Ishëm, ndër më të ndoturit në vendin tonë.

MESAZHI I MINISTRIT TË MJEDISIT, Z. LEFTER KOKA

Sot inauguroam impiantin e pastrimit të grykëderdhjes së lumit Shkumbin, i njohur si një nga grykëderdhjet më problematike në vend. Sot kemi një investim të përkryer, që disiplinon qoftë mbetje e ngurta, ato plastike dhe vajrat.

40 hektar bregdet në Vllë-Bashtovë, Kavajë, rikthehen për pushuesit. Vetëm 1 vit më parë, kjo vijë bregdetare shënonte një gjendje alarmante, për sa i përket ndotjes mjedisore. Sot, kjo vijë bregdetare e pastër dhe e shëndetshme, është gati të mirëpresë turistët.

Punë kolosale e Ministrisë së Mjedisit, në të gjithë Shqipërinë, në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Kemi bërë shumë në këto 4 vite, për sa i përket menaxhimit të mbetjeve, edhe më shumë nga sa premtuam e i vumë objektivin vetes, në shtator 2013. Menaxhimi i mbetjeve ngelet ende një problematikë madhore dhe bashkitë duhet ta kuptojnë që ligji ngarkon direkt ato- për pastrimin e mbetjeve.

Por kjo çështje kërkon impenjim kombëtar, jo vetëm të Qeverisë dhe të Ministrisë së Mjedisit, por edhe të gjithë qytetarëve shqiptarë, duke sensibilizuar që të mos ndotim më lumenjtë, ku çdo mbetje shkon direkt në 2 detet tona, atë Adriatik dhe Jon.

MINISTRI KOKA: PARQET DHE ZONAT E MBROJTURA, BURIME TË RËNDËSISHME EKONOMIKE PËR VENDIN



24 Maj- Në Ditën Evropiane të Parqeve, Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka ishte në Parkun Kombëtar "Mali i Dajtit", ku inauguroi disa investime të rëndësishme në zhvillimin e zonave të mbrojtura. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, ku ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Delegacionit Evropian, Ministri Koka theksoi rëndësinë e parqeve në jetën e qytetarëve.

"Në këtë Ditë Evropiane të Parqeve, duam të shprehim se edhe Shqipëria i konsideron këto vende glodhëse, si një aset i gmuar jo vetëm i natyrës e të mjedisit, por edhe për ekonominë e vendit. Shqipëria ka rreth 15 parqe kombëtare të shpallura në më shumë se 50 vite, si Parku Kombëtar i Dajtit, që është shpallur i tillë në vitin 1966. Parqet janë mushkëritë jo vetëm të zonave ku ndodhen, por edhe të vetë qyteteve të mëdha urbane, siç është dhe ky park.

Këtë Park do ta konsideroja edhe si një zonë ekonomike shumë të rëndësishme për qytetin e



Tiranës", - tha ministri Koka. Gjatë vizitës së tij, ministri



Koka inauguroi fillimisht qendrën e re të vizitorëve, e cila do të jetë një pikë informacioni dhe shërbimi e kualifikuar për çdo turist vendas dhe të huaj. Ministri i Mjedisit inspektoi gjithashtu, edhe rikonstruksionin e "Shtëpizës së Reinshërsave" në hyrje të Parkut Kombëtar, si dhe investimet në logjistikë për stafin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura të financuara nga Natura 2000.

Duke vijuar mesazhin e tij në Ditën Evropiane të Parqeve, Ministri Koka theksoi faktin se sa vëmendje është treguar për ruajtjen dhe shtimin e zonave të mbrojtura, në pishat katër vite.

"Tashmë kemi mbërritur nivelin e 17% të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura në territorin shqiptar, të klasifikuara në nivele të ndryshme", tha ministri Koka, duke shtuar se: "Krijimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, dhe autonomia financiare që ky institucion do të marrë nga ligji i ri i zonave të mbrojtura, të miratuar më 4 maj 2017, në Parlamentin Shqiptar, është një zhvillim i rëndësishëm.

Filozofia jonë nuk është që një zonë apo park kombëtar të qëndrojë thjesht dhe vetëm i

rrethuar si një objekt i pavizitueshëm, por që të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme dhe t'u shërbejë qytetarëve shqiptarë dhe turistëve të huaj. Nuk mund të vazhdojmë me të njëjtën filozofi, ku shumë qytetarë shqiptarë që duhet të udhëtojnë qindra mijëra kilometra larg në vende të huaja për të pushuar. Ne kemi të gjitha mundësitë, të gjitha resurset, kemi njerëz të mrekullueshëm të cilët mund të ofrojnë shërbime të mrekullueshme, qoftë për të pushuar apo për t'u argëtuar, dhe aq më shumë për t'i parë fëmijët të lumtur, ndaj ky është misioni ynë. Nuk mundemi dhe nuk do ta lejojmë kurrë që nesër të jemi të keqgjyqur nga ky brez, për të cilin jemi të lumtur që e kemi"- përfundoi mesazhin e tij ministri Koka.

Dita Evropiane e Parqeve shërben për të promovuar zonat e mbrojtura dhe për të theksuar rëndësinë e mbrojtjes, menaxhimit, por edhe frekuentimit të tyre. Parqet kombëtare janë oaze të natyrës, që ofrojnë për çdo qytetar qetësi, duke lidhur më shumë njerëzit me mjedisin.



NË KËTË NUMËR:

INAUGUROHET IMPIANTI I PASTRIMIT TË GRYKËDERDHJES SË LUMIT SHKUMBIN PËRBUROHET IMPIANTI I PËRPUKIMIT TË MBETJEVE NË ELIASAN- MODEL I VERTETË SUKSESLE

MINISTRI KOKA: PARQET DHE ZONAT E MBROJTURA, BURIME TË RËNDËSISHME EKONOMIKE PËR VENDIN

22 MAJ—DITA BOTËRORE E BIODIVERSITETIT

MIRATOHET LIGJI I RI I ZONAVE TË MBROJTURA

"Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxirrur dhe bashkënduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik".

MESAZHI I MINISTRIT TË MJEDISIT Z. LEFTER KOKA NË KUADËR TË DITËS NËRKOMBËTARE TË BIODIVERSITETIT

Sot është Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit. Kjo ditë, nga më të rëndësishmet në kalendarin mjedisor botëror, festohet këtë vit me moton "Biodiversiteti dhe Turizmi i Qëndrueshëm", duke sjellë në vëmendje raportin e drejtë që duhet të ekzistojë midis natyrës dhe zhvillimit. Një sektor turistik i mirëmenaxhuar mund të ndikojë ndjeshëm në reduktimin e kërcënimeve, ruajtjen ose rritjen e popullatave të faunës së egër dhe vlerave të biodiversitetit.

Sa i takon Shqipërisë jam besimplotë se vendi ynë i ka të gjitha shanset për të zhvilluar një ekoturizëm model në rajon, falë bukurive që natyra na ka dhënë. Ekoturizmi merr më shumë kuptim në zonat e mbrojtura, që në këto katër vite kanë rijohur një zhvillim të jashtëzakonshëm falë politikëbërjes vizionare të Ministrisë së Mjedisit dhe punës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

Kjo ditë ofron edhe një mundësi më shumë për t'u ndërgjegjësuar dhe për të kontribuar në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit. Më lejoni t'ju kujtoj se edhe kontributi më i vogël i çdo qytetari vlen për bërë ndryshimin.

Të gjithë bashkë, kemi shansin për të ruajtur mjedisin përmes një zhvillimi të qëndrueshëm dhe miqësor të burimeve të yvera natyrore që ka vendi ynë.



Në ditën Ndërkombëtare të Biodiversitetit mund të përmendim arritjet që ka pasur Ministria e Mjedisit në fushën e biodiversitetit gjatë këtij viti. Është miratuar **Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit**, i cili përmban dhe Planin e Veprimit, dhe është i vlefshëm për periudhën deri në vitin 2020. Një nismë tjetër ligjore që ka ndërmarrë Ministria e Mjedisit, gjatë vitit 2016, ishte ripërsëritja e **ligjeve për moratoriumin e gjuetisë** për një periudhë 5-vjeçare. Kjo periudhë ka shërbyer për rimëkëmbjen e mëtejshme të popullatave, si dhe për plotësimin e kuadrin ligjor kombëtar. Gjithashtu, është miratuar **metodika për inventarizimin dhe monitorimin e llojeve, objekte gjuetie**. Gjithashtu, janë mundësuar **trajnimet të stafit** që do të kryejnë këtë proces të rëndësishëm, për sigurimin e të dhënave për biodiversitetin. Në këtë kontekst janë kryer **dy censuse për shpendët dimëruar**, duke kontribuar në plotësimin e një tabloje të qartë për trendin e popullatave të faunës së egër

në vend. Gjatë kësaj periudhe u ndërmorën nisma për **shpalljen e dy zonave të reja të mbrojtura, që janë Zona e Mbrojtur Detare Porto-Palermo dhe Parku Kombëtar i Alpeve**. Pas miratimit të tyre, do të bëhet e mundur rritja e sipërfaqes së mbrojtur në mbi 17% të territorit të vendit, duke arritur kështu edhe detyrimin që rrjedh nga Konventa e Biodiversitetit. Veç kujdesit për përmirësimin e legjislacionit në fushën e biodiversitetit, Ministria e Mjedisit ka financuar apo mbështetur dhe një sërë nismash, për **rehabilitimin e sipërfaqeve të degraduara**, nëpërmjet fushatave të mbjelljes së pemëve në zona të ndryshme të vendit. Një kujdes të veçantë Ministria e Mjedisit i ka kushtuar dhe rritjes së ndërgjegjësimit të publikut për kujdesin që duhet të tregojë për mjedisin në përgjithësi, por dhe për biodiversitetin në veçanti, përmendim këtu **rehabilitimin e qendrave të informacionit** në disa zona të mbrojtura, si dhe rehabilitimin e infrastrukturës në brendësi të zonave të mbrojtura, si hapje shtigjesh apo vendosja të tabelave informuese në

këto zona. Ministria e Mjedisit, gjatë këtij viti, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Qendrën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, po punon për të aplikuar për nominimin e zonës së Liqenit të Prepës, si zonë e UNESCO-s.

PAK HISTORI

Në dhjetor 2000, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara shpalli 22 Majin, si Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit, për të kujtuar miratimin e tekstit të Konventës së Diversitetit Biologjik.

Tema e shpallur për vitin 2017 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara është "Viti Ndërkombëtar i Turizmit të Qëndrueshëm për Zhvillim."

Festimi i Ditës Ndërkombëtare të Diversitetit Biologjik në këtë temë, ofron një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin dhe veprimin ndaj kontributit të rëndësishëm të turizmit të qëndrueshëm, si për rritjen ekonomike, ashtu edhe për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit.

MIRATOHET LIGJI I RI I ZONAVE TË MBROJTURA

4 Maj— Ministria e Mjedisit në bashkëpunim dhe me Agjencinë e Zonave të Mbrojtura, vijon punën për hartimin e legjislacionit në këtë fushë. Ditët e para të muajit maj kaloi në Parlamentin Shqiptar, projektligji "Për Zonat e Mbrojtura".

Ky ligj ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin, përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe të burimeve të tyre natyrore e biologjike, në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për të garantuar përmbushjen e funksioneve mjedisore, ekonomike, sociokulturore, në interes të të gjithë shoqërisë, si dhe përcaktimi i përgjegjësive të institucioneve publike dhe personave fizikë/juridikë privat, për ruajtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të tyre.

Ligji është ndërtuar me 11 krahë, ku në Kreun I përcaktohet jo vetëm qëllimi dhe parimet e këtij akti ligjor, por përcaktohen dhe përkufizimet për konceptet dhe strukturat që përmenden gjatë këtij akti. Kreu II përcakton ndarjet e zonave të mbrojtura, thekson mënyrën e shpalljes së tyre, si dhe kategorizimin e zonave të mbrojtura, sipas rëndësisë dhe pasurisë natyrore që ato kanë. Sipas llojit të interesit për të cilin kanë marrë statusin e mbrojtjes, zonat ndahen në: a) zona të mbrojtura me interes kombëtar; b) zona të mbrojtura me interes ndërkombëtar ku bëjnë pjesë: i) zonat "Ramsar"; ii) zonat me interes për Komunitetin Evropian (SACs), ku bëjnë pjesë zonat e veçanta të ruajtjes të habitateve dhe të shpendëve (SCI dhe SPAs); iii) zonat me interes të veçantë ruajtjeje (zonat e rrejtë Emerald); iv) zonat "Rezervë të biosferës"; v) zonat e trashëgimisë

natyrore.

Ndërsa ka mbetur i pandryshuar numri i kategorive të zonave të mbrojtura, ndryshimi është në kategorinë VI, ku është shtuar kategorizimi "Park natyror bashkiak", dhe është futur në ligj dhe kategorizimi "Kurorë e gjelbrë (kategoria V)".

Në këtë ligj është përfshirë dhe Zona e Mbrojtur Detare, dhe një zonë që e ka fituar tashmë këtë status është Narta.

Gjithashtu, brenda kategorisë së zonave të mbrojtura janë shtuar dhe elementet turistike natyrore, si kanionet dhe ujëvarat, duke i konsideruar dhe ato tashmë monumente të natyrës.

Risi në këtë ligj ka roli që i është dhënë pushtetit vendor, rol që fillon nga procesi i shpalljes së një zone të mbrojtur dhe që vijon edhe me kompetencën në administrimin dhe monitorimin e këtyre pasurive natyrore, që shtrihen brenda territorit që autoriteti lokal administro.

Po ashtu, një rol i veçantë rëndësishëm merr në këtë akt ligjor dhe administrata e zonave të mbrojtura, si autoriteti shtetëror qendror, i cili përgjigjet për administrimin e tyre. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura është krijuar në vitin 2014, por tashmë roli i saj është i përcaktuar në mënyrë të detajuar në ligjin e miratuar këto ditë.

Element i rëndësishëm për miradministrimin e këtyre zonave, është dhe aspekti financiar, i cili nuk ka qënë i përcaktuar si duhet në aktet e mëparshme ligjore. Tashmë të ardhurat që do të përfitohen nga zonat e mbrojtura, do të rikthehen në inves-

tite konkrete në këtë zonë, sipas tarifave dhe rregullave që do të përcaktohen me Ministrinë e Financave.

Element tjetër i rëndësishëm është informimi i publikut dhe transparenca në vendimmarrje për këto zona me pasuri natyrore. Në ligjin e ri, sanksionohet e drejta e shoqërisë civile gjatë të gjitha fazave të menaxhimit të një zone të mbrojtur, duke filluar që nga faza e marrjes së mendimeve për shpalljen e një zone e deri tek hartimi i planit të menaxhimit të saj.

Një vlerë të veçantë në ligjin e sapohyrë në fuqi, merr dhe neni 16, ku theksohet që në këto zona të mbrojtura nuk lejohet ndërtimi i hidrocentraleve, problem ky që ka qënë dhe është mjaft shqetësues për të gjithë shoqërinë shqiptare, veçanërisht në këto vitet e fundit, ku institucionet shtetërore janë paditur në gjykata për dhënie lejesh, për ndërtime hidrocentralesh në zona të mbrojtura. Ndalmi shprehimisht në këtë ligj sjellë një lajm pozitiv për të gjithë.

Drafti i këtij ligji ka qarkulluar më shumë se një vit në dëgjesa publike të organizuara pranë Zonave të Mbrojtura, grupeve të interesit dhe pjesës akademike që merret me florën e faunën në Shqipëri. Si rrallëherë ka pasur më shumë se 12 takime për marrje mendimi, përfshirë edhe institucionet e huaja e donatorët. Sipas drejtorit të Agjencisë së Zonave të Mbrojtura, z. Zamir Dedej, janë më shumë se 80% e mendimeve të dhëna të përfshira në draft". Ky ligj ka munduar të përafrojë dhe Direktivën e Bashkimit Evropian në këtë fushë.

STUDENTËT PËRFUNDOJNË PROJEKTIN E TYRE PËR QENDRËN E AARHUSIT TIRANË



Studentët e Fakultetit të Arkitekturës u bënë pjesë e një iniciative “365 Orë për Mjedisin”, për të dizenuar Qendrën Aarhus për Tiranën, e cila shërben për të rritur aksesin e publikut në informacion mbi mjedisin, mbi vendimarrjet që lidhen me të.

Katër muaj pas nënshkrimit të Memorandumit mes Ministrisë së Mjedisit, UNDP-së dhe Universitetit Politeknik të Tiranës, studentët e arkitekturës prezantuan në Hotel Tirana, projektet e tyre të përfunduara për rikonstruksionin e hollit të Ministrisë së Mjedisit në një qendër që do të shërbejë për dhënien e informacionit mjedisor, dhe si një vend takimi me organizatat mjedisore dhe partnerët e ndryshëm të interesuar për çështjet mjedisore. Në këtë aktivitet mermin pjesë: drejtorja e UNDP-së në Shqipëri, znj. Liryma Eltayeb, shefi i kabinetit të ministrit të Mjedisit, z. Argjent Alltari, përgjegjësi i katedrës së arkitekturës, z. Daniel Qamo, i cili ishte dhe drejtuesi i studentëve në këtë nismë.

Drejtori i Kabinetit z. Alltari, theksoi rëndësinë që ka kjo qendër për Ministrinë e Mjedisit “Qendra e Aarhusit, siç ne e dimë të gjithë, është një Qendër, që duhet të ofrojë informacion mjedisor në mënyrë të vazhduar, pa asnjë shprehje

interesi nga publiku. Kjo Qendër duhet të punojë në mënyrë të vazhduar, për të krijuar mundësitë e tërheqjes së mendimit të publikut, për planet, programet, strategitë dhe legjislacionin në fushën e mjedisit. Gjithashtu, kjo Qendër duhet të punojë për të krijuar kapacitetet, për tërheqjen e mendimit të publikut, për të gjitha aktivitetet që kanë ndikim në mjedis, si dhe të koordinojë punën, për t'i krijuar mundësi publikut, për t'iu drejtuar gjykatës për çështje mjedisore. Gjithashtu, kjo Qendër që në krijimin e vet në 2006 është ideuar të jetë një link mes Ministrisë së Mjedisit dhe shoqatave mjedisore për të bashkëpunuar në fushën e mjedisit. Të gjitha këto sfida që kjo Qendër ka përpara, e bëjnë këtë financim, të marrë vlera shumë të veçanta”.

Në fjalën e saj znj. Eltayeb theksoi se “Në fushën e Mjedisit ka një numër të konsiderueshëm konventash, të cilat janë mjaft të rëndësishme, dhe që Shqipëria është palë dhe çdonjëra prej tyre ka rëndësinë e saj, një nga këto konventa mjaft të rëndësishme është dhe Konventa e Aarhusit, e cila ka si fokus rritjen e transparencës dhe demokracisë në fushën e Mjedisit”.

Gjithashtu, ajo theksoi dhe rëndësinë e angazhimit dhe rolit aktiv që duhet të kenë brezat e rinj, për të dhënë kontribut direkt për çështjet mjedisore. Nga ana e saj ajo siguroi se

UNDP-ja në Shqipëri do të vazhdojë mbështetjen e iniciativave në këtë drejtim.


Më pas të 11 grupet e studentëve shpjeguan projektin e tyre, cilat ishin pikat e dobëta që kishin hasur gjatë punës së tyre dhe cilat ishin elementet që ata do të donin të theksonin me projektin që kishin paraqitur. Ishte vërtet mbresëlënëse mënyra e prezantimit të punës së tyre, po aq mbresëlënëse ishte dhe projekti që ata kishin ideuar.

Ishte vërtet kënaqësi kur shihje se sa efikase mund të bëhet një bashkëpunim mes ekzekutivit, donatorit dhe universiteteve tona. Gjatë prezantimit të projekteve të realizuara nga studentët, kuptoje se shkollat tona nxjerrin studentë mjaft të talentuar, pasi shihje tek ata dëshirën për të punuar.

Në stendën e njëmbëdhjetë, ishte projekti përfundimtar, i cili kishte marrë ide nga të gjitha punimet e studentëve dhe ishte varianti që do vihej në zbatim në hollin e Ministrisë së Mjedisit. Falë punës së mrekullueshme të këtyre studentëve dhe financimit mjaft të gjetur të UNDP-së, Ministria e Mjedisit do të ketë tashmë, një hyrje të denjë për një institucion qendror të një vendi që aspiron të bëhet anëtar i Bashkimit Evropian.



10 MAJI DO TË FESTOHET NË SHQIPËRI SI DITA E PELIKANIT KAÇURREL



Ministria e Mjedisit shpall Ditën e Pelikanit Kaçurrel, Ditë Kombëtare Mjedisore. Me një urdhër të firmosur nga Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, data 10 Maj e çdo viti në Shqipëri, shënohet në Kalendarin Kombëtar Mjedisor, si “Dita e Pelikanit”. Në urdhër caktohet që në kuadër të kësaj dite, e cila përputhet me Ditën Ndërkombëtare të Shpendëve Migratorë, duhet të organizohen aktivitetet e ndryshme ndërgjegjësuese, edukuese dhe promovuese të vlerave natyrore dhe ekoturistike të këtij lloji në zonën e Parkut Kombëtar Divjakë- Karavasta, si dhe në zona të tjera ligatimore të Shqipërisë, në bashkëpunim me organizatat mjedisore, njësitë e qeverisjes vendore, strukturat arsimore etj. Bashkë me shpalljen e kësaj dite mjedisore, ministri Koka ka miratuar edhe Planin Kombëtar të Veprimit për ruajtjen e Pelikanit Kaçurrel, një specie e rrezikuar në nivel global dhe kombëtar, si dhe një lloj

simbol i shpendëve në Shqipëri dhe më gjërë.

Objektivat kryesorë të Planit Kombëtar të Veprimit për ruajtjen e Pelikanit Kaçurrel në Shqipëri, konsistojnë në rritjen e popullatës folezuese të Pelikanit Kaçurrel, mbrojtjen dhe ruajtjen e habitateve kritike të tij në vendin tonë, si edhe sigurimin e një shtese të vendeve të folezimit aty ku kjo është e mundur. Ndërsa veprimet konservuese të parashikuara në plan janë: përmirësimi i politikave dhe të legjislacionit, administrimi i llojit dhe ruajtjen e habitateve, monitorimi i Pelikanit Kaçurrel, nxitja e edukimit dhe trajnimit për ruajtjen e mëtejshme të tij, nxitja e aktivitetëve ndihmuese e të qëndrueshme etj. Pelikani Kaçurrel ka pasur një shpërndarje të reduktuar ndër vite deri në minimum, si pasojë e humbjes së habitateve jetike. Por, politika e ndjekur vitet e fundit nga Ministria e Mjedisit ka sjellë qetësinë në laguna dhe rezultate të dukshme të pranisë së Pelikanit Kaçurrel. Prani e vërtetuar edhe nga rezultatet

pozitive të Censurit të dytë Kombëtar për Pelikanin Kaçurrel që u mbajt në kuadër të Censurit Rajonal të Evropës Juglindore në Shqipëri, Mali i Zi, Greqi, Rumani, Bullgari, Turqi dhe Ukrainë, që u mbyll në datën 6 maj 2017.

Për shtimin e Pelikanit Kaçurrel u shpreh ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka “Prej shumë vitesh Pelikani Kaçurrel nuk shihej në ligatinat tona. Me hyrjen në fuqi të moratoriumit të gjuetisë, brenda një kohe mjaft të shkurtër, kjo specie e rrallë u rikthye sërish në natyrën tonë, falë qetësisë së rëndësishme. Vit pas viti rezultatet tregojnë për një realitet pozitiv në ligatinat tona, dhe ja ku Shqipëria kryen Censurin Rajonal për Europën Juglindore për vitin 2017. Gjatë këtij censusi, të mbajtur pak ditë më parë, 18 pelikanë kaçurrelë janë regjistruar në ujërat e liqenit të Shkodrës, duke u ushqyer të qetë në habitatin e tyre”- përfundon reagimi i ministrit Koka në rrjetet sociale.

DITA BOTËRORE E SHPENDËVE SHTEGTUES



10 Maji është Dita Botërore e Shpendëve Shtegtues. Kjo ditë, pas urdhrat të ministrit të Mjedisit z. Lefter Koka, tashmë do të festohet në Shqipëri. Këtë vit aktivitetet u zhvilluan në qytetet e Gjirokastrës, Vlorës, Sarandës.

Administrata e zonave të mbrojtura **Gjirokastrë** me rastin e 10 Majit " Ditës Ndërkombëtare të Shpendëve Shtegtues", në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore të qytetit, si dhe me Shoqatën e Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri, organizoi një aktivitet në shkollën e mesme të bashkuar Dervician dhe në shkollën e mesme të bashkuar Kardhiq, ku nxënësit u njohën me llojet e shpendëve shtegtare të zonës së Gjirokastrës, si dhe me llojin simbol shtegtare të kësaj zone, Kalin e Qyqes (Neophron percnopterus). Pas prezantimit të filmit të shkurtër “Jetë për Kalin e Qyqes”, nxënësit mësuan më shumë rreth

shpendit simbol të Gjirokastrës, Kalit të Qyqes dhe shpendëve të tjerë shtegtues.

Pas prezantimit të metodave të kundërimit të shpendëve, eksperti i shpendëve i PPNEA-s u dhuroi bibliotekave të secilës shkollë 2 kopje të udhëzuesit të parë, të plotë, të shpendëve të Shqipërisë. Në këtë takim vihej re interesi i treguar nga nxënësit për mbrojtjen dhe promovimin e këtyre shpendëve, si vlerë e veçantë ekologjike dhe turistike të rrethit të Gjirokastrës.


Vlorë. Në kuadër të ditës Botërore të Shpendëve Shtegtare, AdZM-ja Vlorë, në bashkëpunim me PPNEA-n, organizoi një orë ndërgjegjësuese me klasën e 11-të të shkollës së mesme "Hasan Mehilli", në Dukat të ri. Në vazhdim, në bashkëpunim me organizatën SEEP, u zhvillua aktiviteti “ Birdwatching” në Lagunën e Nartës, me studentë dhe nxënësit të

shkollave të mesme.



Po ashtu, aktiviteti u shtri dhe në qytetin e Sarandës, ku u organizuan aktivitetet edukuese me nxënësit të klasave fillore të shkollave “Mehmet Xhaferri” në Xarrë dhe “Sotir Dell” në Mursi. Menjëherë pas prezantimit të pesë shpendëve shtegtues, si dallëndyshja bishtëgërshtëre, lejlaku, qyqja, deka dhe gargulli, u organizua edhe një ekskursion në natyrë, për të kundëruar këta shpendë. Tashmë nxënësit me ndihmën e mësuesve dhe prindërve do të regjistrojnë vëzhgimet e tyre për këta shpendë në faqen elektronike të SA-it, duke krijuar kështu një hartë në kohë reale.





AKTIVITETE NGA SHOQATAT MJEDISORE

EDEN PREZANTON MONITORIMIN E INSTITUCIONEVE PUBLIKE PËR LIGJIN E KONSULTIMIT

Qendra Mjedisore EDEN, në datë 16 maj 2017, pranë Hotel Tirana International, zhvilloi takimin "ALTOPARLANT", ku prezantoi raportin mbi zbatimin e Ligjit 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Vetë titulli i veçantë i ideuar për këtë takim, lë të kuptojë rëndësinë që ka informimi i duhur dhe angazhimi i çdo qytetari në vendimarrjen publike, mundësi dhe të drejtë që ia siguron Ligji 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Për nga vetë rëndësia që ka ky ligj për demokracinë, transparencën dhe forcimin e rolit të qytetarit në vendimarrje, qendra "EDEN" monitoroi ligjin e njoftimit dhe konsultimit dhe zbatimin e tij në kontekstin e vendimeve me ndikim në mjedis. Monitorimi u zhvillua gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2016, në 10 institucione publike, që në mënyrë direkte apo indirekte janë të lidhura me sektorin e mjedisit. U përzgjedhën 8 nene për t'u monitoruar, të cilët i japin identitetin ligjit dhe përmbushin qëllimin e tij. Pasi u identifikuan 23 indikatorë monitorimi, këta indikatorë u monitoruan më pas për çdo institucion. Të pranishëm në takim ishin përfaqësues të shoqërisë civile, koordinatorët e njoftimit dhe konsultimit publik në institucionet përkatëse të monitoruara në këtë raport dhe institucione të tjera të linjës; përfaqësues të Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe Ambasadës Suedeze, studentë e qytetarë të interesuar. Pjesë e panelit të ftuar ishin: znj. Anola Xhuli, drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Juridike në institucionin e Komisionit për të Drejtën e

Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; z. Enio Haxhimihali, drejtor Kabineti tek institucioni i Avokatit të Popullit; z. Antoine Avignon - menaxheri i sektorit të Mjedisit, Energjisë, Infrastrukturrës dhe Mbrojtjes Civile, delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri; z. Rezart Kapedani, menaxheri granti, Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri; znj. Ermelinda Mahmutaj, drejtore e ekzekutive e Qendra Mjedisore EDEN, e cila prezantoi raportin e hartuar. Moderimi u krye nga gazetari, z. Ben Andoni. Takimi u ndoq me diskutime nga organizatat mjedisore me raste konkrete të rëndësishme së njoftimit dhe konsultimit publik, si dhe koordinatorët e njoftimit të pranishëm, të cilët shpjeguan procedurën e ndjekur nga institucioni i tyre për njoftimin dhe konsultimin bazuar në ligjin përkatës. Panelistët në vija të përgjithshme ndanë me të pranishmit eksperiencën e tyre me ligjin "Për njoftimin dhe konsultimin publik", si dhe theksuan rëndësinë që ka ky ligj, mundësinë që i jep qytetarit për t'u përfshirë në proceset vendimarrëse, si edhe rolin kyç që kanë organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet shtetërore, për të ndërgjegjësuar individët drejt mekanizmave ligjorë që janë në funksion dhe në dobi të qytetarëve. Në këtë takim, u gjendën së bashku disa aktorë kyç, të cilët ndikojnë dhe ndërveprojnë për respektimin dhe njohjen e ligjit, i cili i jep "zë" të drejtave të individit dhe fuqizon rolin thelbësor, që secili nga ne ka në proceset vendimarrëse.



MALËSI E MADHE: SFIDAT E Pjesëmarrjes Publike në Vendimarrje.

Sfidat e pjesëmarrjes publike në vendimarrje ishte fokusi i forumit qytetar organizuar në bashkinë Malësi e Madhe, në kuadër të programit "ACHIEVE" të zbatuar nga REC Shqipëri dhe projektit "Një hap më tej drejt rritjes së pjesëmarrjes së gra në vendimarrje" në bashkinë Malësi e Madhe zbatuar nga shoqata "Gruaja në INTEGRIM". Nisma e mbështetur financiarisht nga delegacioni i BE-së në Shqipëri, kishte si qëllim të adresonte rritjen efektive të pjesëmarrjes publike në vendimarrje për çështjet e mjedisit. Ky takim mbledhi së bashku autoritete vendore të Malësisë së Madhe, komunitetin e biznesit, operatorëve turistikë, përfaqësues të bashkisë, shoqata të shoqërisë civile, të rinj e aktorë të tjerë të interesuar.

21 MAJ- DITA EVROPIANE E Deteve/ European Maritime Day
Në kuadër të kësaj iniciative, një grup studentësh të organizuar nga **Organizata SEEP**, zhvilluan një aktivitet pastrues në Parkun Detar Karaburun Sazan, me qëllim pastrimin e plazheve dhe detit nga mbetjet plastike. Detet dhe oqeanet janë resurse të rëndësishme të planetit dhe të ekonomisë në Evropë. Kjo është një ditë ndërgjegjëse për të gjitha autoritetet shtetërore të nivelit lokal dhe qendror, grupeve të interesit dhe publikut të gjerë, për problematikën që i shkaktohet deteve dhe oqeanëve nga aktiviteti njerëzor, problematikën që lidhet me planifikimin hapësinor detar, luftën kundër peshkimit të paligjshëm, ndotjen e vazhduar të këtyre hapësirave ujore që shkaktohen nga aktiviteti njerëzor.



BIOLITZI NË MUAJIN MAJ

Në kuadër të Programit Kombëtar për Edukim Mjedisor dhe projektit BioBlitz Albania, grupi i Ministrisë së Mjedisit dhe përfaqësuesja e projektit BioBlitz Albania, gjatë muajit maj vijuan aktivitetet e BioBlitz-it, në qytetet e Korçës, Pogradecit, Tropojës dhe Gjirokastrës. Ky aktivitet, i cili ka gati një vit që po aplikohet në një shkollë të çdo qyteti të Shqipërisë, kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të fëmijëve për mjedisin, për të kuptuar nga ata nëse e njohin si duhet mjedisin që i rrethon, dhe se si mund ta mbrojnë më mirë atë.

Në aktivitetin BioBlitz, nxënësit mësohen se si të ndihmojnë për të identifikuar sa më shumë specie që të jetë e mundur në zonën e tyre natyrore.

Përmes kësaj veprimtarie, nxënësit njihen se si të përdorin harta dhe përfaqësimet e tjera gjeografike, teknologji gjeohapësinore dhe të menduarit hapësinor, për të kuptuar dhe komunikuar informacionet që lidhen me mjedisin.

Vetëm brenda muajit maj, nga grupi i BioBlitz Albania u mundësua ndërgjegjësimi i rreth 300 nxënësve, të cilët gjatë orëve të hapura u njohën me rëndësinë e edukimit mjedisor; me të drejtat që burojnë nga Konventa e Aarhusit, më pas vijohet me shfaqjen një video promovuese nga natyra shqiptare, duke u shpjeguar biodiversitetin e vendit tonë. Gjithashtu iu bëhet një prezantim i shkurtër për rëndësinë e rrjetëve natyrore si dhe Zonat e Mbrojtura apo Natura 2000. Në fund iu prezantohet iniciativa e BioBlitz-it dhe më pas zbritet në oborrin e shkollës për ta praktikuar konkretisht në gjetjen e specieve në një zonë të gjelbëruar pranë shkollës së tyre.

